



ALBANIAN INFORMATION and COMMUNICATION TECHNOLOGY ASSOCIATION

PAKETA e  
ANËTARËSISË NË AITA  
2013



## **Paketa e Anëtarësisë në AITA, 2013**

### **Përmbajtja**

Anëtarësia në AITA _____	3
‘Anëtar i Plotë’ _____	3
Avantazhet për ‘Anëtarin e Plotë’: _____	3
‘Anëtar i Asociuar’ _____	4
Avantazhet për ‘Anëtarin e Asociuar’: _____	4
AITA për ANËTARËT _____	5



## Anëtarësia në AITA

Anëtarët e AITA janë kompani, Institucione Arsimore, Profesionistë dhe OJQ, që veprojnë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit-TIK.

### Kuota e Anëtarësisë

Kuota e anëtarësisë është **12000 lekë** (TVSH e përfshirë).

### Detyrimi për Pagesën e Kuotës së Anëtarësisë

Kompanitë private e kanë të detyruar pagesën e kuotës së anëtarësisë së AITA dhe rrjedhimisht fitojnë statusin 'Anëtar i Plotë'.

Institucionet akademike, Profesionistët dhe OJQ-të gëzojnë të drejtën e zgjedhjes për pagesën ose jo të kuotës së anëtarësisë në AITA. Statusi për mos-pagesë është 'Anëtar i Asociuar'.

## 'Anëtari i Plotë'

**Anëtarët e plotë të AITA, pagues të kuotës së anëtarësisë**, kanë të drejtën të votojnë mbi të gjithë temat që adresohen nga shoqata dhe nga grupet e punës krijuar në shoqatë, të cilave anëtarët kanë të drejtë dhe dëshirë t'u bashkohen.

Çdo anëtar që ka paguar kuotën e anëtarësisë ka një votë.

Votat e anëtarëve kanë peshë të barabartë.

### Avantazhet për 'Anëtarin e Plotë':

- Mund të marrë pjesë dhe të kontribuojë në diskutime në kuadër të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve;
- Ka të drejtën të votojë në Mbledhjen e Përgjithshme;
- Ka mundësinë të kandidojë për pozicionet drejtuese të shoqatës (Presidenca dhe Bordi);
- Mund të marrë pjesë në komisionet dhe grupet e punës të krijuara nga shoqata;
- Ka të drejtën të komunikojë direkt dhe të paraqesë propozime mbi aktivitetet e shoqatës tek Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv;
- Ka mundësinë të përfshihet në aktivitetet e AITA si komunikimi me institucionet, pranimi i informacionit mbi mundësitë e bashkëpunimit, pranimi i informacioneve mbi projekte të reja, pjesëmarrje në projekte të inicuar nga AITA ose anëtarë të saj, etj;
- Ka mundësinë të përfshihet në databazën dhe 'Katalogu i Anëtarëve' me produktet dhe shërbimet e listuara, të cilat do të përdoren për të hyrë në kontakt dhe për të pasur komunikim me klientë dhe partnerë potencialë;



- Ka mundësinë të sigurojë skonto në çmimin e pjesëmarrjes në seminare ose ngjarje të tjera TIK të bashkë-organizuara nga AITA;
- Ka mundësinë të marrë informacion të shpejtë mbi të gjithë temat dhe aktivitetet që zhvillohen nga shoqata;
- Ka mundësinë të zhvillojë rrjetëzim me anëtarët e AITA dhe anëtarët e shoqatave të shteteve të tjera me të cilat AITA bashkëpunon.

## **‘Anëtari i Asociuar’**

Institucionet akademike, Profesionistët dhe OJQ-të gëzojnë të drejtën e zgjedhjes mbi llojin e anëtarësisë të tyre në shoqatë. Nëse ata zgjedhin të mos të paguajnë kuotën e anëtarësisë së shoqatës, ata mund të anëtarësohen si anëtarë të asociuar në AITA.

### **Avantazhet për ‘Anëtarin e Asociuar’:**

- Mund të marrë pjesë dhe të kontribuojë në diskutime në kuadër të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Anëtarëve;
- Mund të marrë pjesë në komisionet dhe grupet e punës të krijuara nga shoqata;
- Ka të drejtën të komunikojë direkt dhe të paraqesë propozime mbi aktivitetet e shoqatës tek Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv;
- Ka mundësinë të përfshihet në aktivitetet e AITA si komunikimi me institucionet, pranimi i informacionit mbi mundësitë e bashkëpunimit, pranimi i informacioneve mbi projekte të reja, pjesëmarrje në projekte të inicuar nga AITA ose anëtarë të saj, etj;
- Ka mundësinë të përfshihet në databazën dhe ‘Katalogu i Anëtarëve’ me produktet dhe shërbimet e listuara, të cilat do të përdoren për të hyrë në kontakt dhe për të pasur komunikim me klientë dhe partnerë potencialë;
- Ka mundësinë të sigurojë skonto në çmimin e pjesëmarrjes në seminare ose ngjarje të tjera TIK të bashkë-organizuara nga AITA;
- Ka mundësinë të marrë informacion të shpejtë mbi të gjithë temat dhe aktivitetet që zhvillohen nga shoqata;
- Ka mundësinë të zhvillojë rrjetëzim me anëtarët e AITA dhe anëtarët e shoqatave të shteteve të tjera me të cilat AITA bashkëpunon.



## AITA për ANËTARËT

AITA u jep prioritet anëtarëve të saj duke zhvilluar aktivitete që të fokusohen në katër kategori themelore: **shërbime për biznesin, trajnime, lobim dhe rrjetëzim.**

### Shërbime për Biznesin

1. Kompania juaj do të mund të përfitojë nga projekte në të cilat AITA përfshihet. **Shembull:** Projekti 3-vjeçar Academic Exchange for Progress-AEP, i cili në Shqipëri ka si partner manaxhues AITA e në kuadër të të cilit (1) studentë të degës së Informatikës Ekonomike në Fakultetin e Ekonomisë në UT dërgohen për një semestër studimi në Gjovik University dhe (2) praktikë pune në Norvegji, ku (3) specializohen për fusha me interes për anëtarët e AITA. Në kthimin në Shqipëri ata zhvillojnë praktikë pune (pa pagesë) dhe/apo punësohen në kompani anëtare të AITA.
2. Kompania juaj rekomandohet tek donatorë të cilët zhvillojnë projekte për rritjen e ndërmarrjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në ekonominë shqiptare, e sektorin e TIK në veçanti. **Shembull:** (1) implementimi i standardit 'IT Mark, iniciuar dhe drejtuar nga USAID Rritje Albania, (2) projekti CEED i USAID, suport për zhvillimin e ndërmarrjeve të reja me mbështetje të ndërmarrjeve më të zhvilluara, (3)programi TAM-Entreprise Growth Program, European Bank for Reconstruction and Development, suport për transformim pozitiv të menaxhimit në ndërmarrjet private.
3. AITA punon për rritjen e mundësive të kontaktit të kompanisë suaj me kompani të huaja me synim rritjen e eksportit të shërbimeve nga kompanitë shqiptare për kompani të huaja në formën e projekteve që mund të bëhen *outsourcing* në Shqipëri.
4. Kompania juaj merr njoftime mbi kërkesa për partneritet nga kompani të huaja të cilat kërkojnë një partner lokal në Shqipëri.
5. Kompania juaj ka mundësinë e njohjes me kompani nga sektorë të tjerë të ekonomisë, bazuar në lidhje të AITA, krijuar me Shoqatën Shqiptare të Turizmit, Shoqatën e Fasonëve, përfaqësues nga sektori i energjetikës, etj.
6. Kompania juaj ka mundësinë e përfaqësimit me kushte të favorshme në aktivitete që zhvillohen në Shqipëri nga organizata të tjera, e në të cilat AITA përfshihet si partner mbështetës. **Shembull:** Konferenca e Shoqatës Shqiptare të Turizmit.
7. Kompania juaj ka mundësinë që përmes aktiviteteve të zhvilluara ose të mbështetura nga AITA të zbulojë talente të reja në sektorin e teknologjisë së informacionit në Shqipëri. **Shembull:** (1) StartUp Weekend, (2) Konkursi i Diplomave, (3) Imagine Cup Albania, Microsoft Albania, apo panairë pune të organizuara nga institucione akademike, shtetërore e private në prag të diplomimit të studentëve.
8. Kompania juaj do të sigurojë të dhënat studimore dhe statistikore mbi sektorin e TIK në Shqipëri, përmes studimeve të rregullta që AITA zhvillon mbi sektorin.



9. Kompania juaj ka mundësinë e vet-promovimit të saj përmes publikimit të profilit në Katalogu i Anëtarëve dhe website zyrtar të AITA.
10. Kompania juaj merr njoftime mbi aktivitetet e shoqatës, pjesëmarrjet në konferenca e forume kombëtare/ndërkombëtare me rëndësi për zhvillimin e sektorit TIK, legjislacionin dhe rregulloret për sektorin e TIK, si dhe tema dhe çështje tjera relevante për sektorin e TIK.

### Trajnime

AITA organizon seminare, workshope dhe trajnime me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të stafit tuaj. *Shembuj trajnimesh të bashkorganizuara nga AITA në vite përfshijnë: **Project Management Training (2 seksione 3-ditore), Lead Auditor ISO 27000 Training (4-ditor), Introduction to Capability Maturity Model Integration (CMMI) Training (4-ditor).***

### Lobimi

Ndër qëllimet parësore të AITA është përmirësimi i vazhdueshëm i mjedisit të biznesit për sektorin e TIK dhe qëndrueshmëria në sektor. Me punën e saj AITA shërben si katalizator për çdo reformë ndihmëse në sektorët publik dhe privat.

### Si funksionon lobimi përmes AITA?

- Pjesëmarrja aktive e kompanisë suaj në Grupin e Punës për Marrëdhëniet me Qeverinë, Grupin e Punës për Edukimin dhe/ose Grupin e Punës për Strategjitë, mund të rezultojë në formulimin e një rekomandimi, i cili në vijim do të mund t'i adresohet Ministrive dhe/ose Agjencive përkatëse në Shqipëri.
- Pjesëmarrja juaj aktive në tryezat e rrumbullakëta që AITA organizon me qeveri, donatorë, universitete, etj. shërben për të adresuar tema me interes për ju, anëtarët e shoqatës, sektorin TIK dhe ekonominë në tërësi.
- Pjesëmarrja juaj në mëngjese pune me përfaqësues nga Qeveria dhe Parlamenti i Shqipërisë për të krijuar një urë direkte komunikimi dhe zëdhënieje për problemet konkrete me të cilat ndeshen kompanitë anëtare.

**Shembull:** Takim i zhvilluar nga AITA me konsulentë të Bankës Botërore pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës lidhur me programin e shkollave të larta 2-vjeçare për Teknologjinë e Informacionit, ku u qartësua pozicioni i sektorit privat lidhur me rëndësinë e zhvillimit të kurrikulave bazuar në nevojën e diktuar nga tregu i punës TIK në Shqipëri.

### Rrjetëzimi

AITA ndihmon anëtarët e saj në rritjen e vizibilitetit dhe lidhjen e tyre me klientë, furnitorë dhe partnerë potencialë biznesi.



Si anëtar i shoqatës, ju do të ftoheni në aktivitete të cilat do t'ju mundësojnë të takoheni dhe bashkëpunoni me përfaqësues lokalë dhe ndërkombëtarë nga administratat publike dhe bizneset private.

AITA jep mundësi për pjesëmarrje në aktivitete rrjetëzuese si panairë, psh. Panairi T.r.e.a AlbExpo), Dita Mbarëkombëtare e TIK (e përvitshme, në bashkëpunim me STIKK – Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit e Kosovës), etj.

Në planet e saj të përvitshme të punës AITA parashikon të zhvillojë konferenca, forume, tryeza të rrumbullakëta e panairë dedikuar sektorit të TIK. Në këto aktivitete pjesëmarrja për anëtarët parashikohet të mundësohet me kushte tejet favorizuese.